



**Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**LEGJISLATURA V**

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Mbledhja nr. 62**

**Prishtinë, më 22.12.2016 në orën 21:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Çeku, Mufera Shinik, Kimete Bytyçi, Ali Berisha, Fisnik Ismaili, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

**Munguan:** Jasmina Zhivković, Milka Vuletiq, Sasha Milosavljeviq dhe Slavko Simiq.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Zijush Ahmeti -konsultant i Sekretariatit të KKK-së, dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Drita Çarkaxhiu ,zyrtare e lart ligjore.

Mbledhjen e kryesoi: **Agim Çeku**, nënkryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

**Rend i ditës**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republokës së Kosovës për vitin 2017, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Agim Çeku, nënkryetar i Komisionit**, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republokës së Kosovës për vitin 2017, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**

**Nënkryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republokës së Kosovës për vitin 2017, me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit që të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim.

**Danush Ademi**, kishte vërejtje lidhur me mos përkrahjen e komisionit funksional në amandamentin 45, të propozuar nga ai, me kërkesë që të ndahen 1.000.000 euro për ndërtimin e shtëpive të familjeve të varëfëra të komuniteteit Ashkali. Ndërkaq, këto familje jetojnë në kushte shumë të vështira dhe Qeveria që 17 vite nuk ka ndërmarr asnjë veprim për komunitetin në fjalë, për këtë arsye nuk do të voton projektigjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

*Pas diskutimeve në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendamente të Komisionit Funksional, kryesuesi konstatoi se Komisioni me pesë vota Për, dy vota Kundër dhe një Apstenim, nxori këtë:*

### **Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republokës së Kosovës për vitin 2017 dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

**Mbledhja përfundoi në orën 21:30.**

**E përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit.**

**Nënkryetar i Komisionit,**

---

**Agim Çeku**